

FJALA E DEPUTETIT ISUF ÇELAJ

E ENJTE 2 DHJETOR 2021

Të nderuar qytetarë të Tropojës,

Të nderuar kolegë,

Sot jam para jush për të ngritur disa probleme dhe shqetësime të banorëve të Tropojës, zonë që përfaqësoj. Hallet e tyre janë të shumta, por sot do të rendis disa më kryesoret, që kanë të bëjnë me kushtet ku ata rrisin fëmijët, pra brezin e ardhshëm. Problematikë për banorët e qytetit të Bajram Currit është gjendja në të cilën ndodhet e vetmja çerdhe që ka qyteti, banorët e të cilit janë të detyruar t'i dërgojnë fëmijët e tyre. Gjendja e saj është mjerane dhe lë shumë për të dëshiruar: ambientet i ka plot lagështi, nuk ka ventilim, nuk ka sistem ngrohjeje, krevatet dyshekët, çarçafët dhe batanijet i kanë të vjetruara, ndërsa muret dhe suvatë të dëmtuara. Kjo është e vetmja alternativë e këtyre prindërve për fëmijët e tyre. Jam shumë i bindur se asnjë nga ministrat e kësaj qeverie, përfshirë edhe Kryeministrin, e asnjë nga ju, kolegë të maxhorancës, nuk do t'i dërgonit fëmijët tuaj në ambiente të tilla, me këto kushte. Ndaj, thirrja ime shkon për Kryeministrin, për ju qeveritarë, për zonjën ministre të Arsimit, që ta financojnë me fonde ristrukturimin e kësaj godine, si dhe pajisjen e saj me orendi të reja, për t'u mundësuar këtyre fëmijëve një trajtim e qëndrim në një ambient me kushte dhe standarde bashkëkohore. Jam i bindur, zonja Ministre, se vlera e këtij investimi është simbolike kur e krahason me shpenzimet e luksit për qeveritarët prej 52 milionë eurosh të kësaj qeverie, të planifikuar dhe miratuar nga ju, në buxhetin e vitit të ardhshëm, ose, e thënë në vlerë, ky financim nuk kalon as 0,4% të vlerës së mësipërme.

Pra, bëhet fjalë për një investim rreth 200-220 mijë euro. E njëjta situatë paraqitet edhe në ambientet e kopshtit nr. 2 të lagjes "Partizani", ku lagështia dhe pajisjet e vjetruara dhe të shkatërruara, niveli i ulët i higjienës sanitare në këto ambiente, me gjithë sakrificën e punonjësve që u shërbejnë fëmijëve të këtij kopshti, janë në gjendje mizerabël. Këto problematika janë të bëra publike në medie edhe para një viti e ca, por askush nga zotërinjtë qeveritarë nuk e ka vënë ujin në zjarr për zgjidhjen e këtyre problemeve, për të bërë të mundur financimin dhe ristrukturimin e këtyre ambienteve, që, edhe ata, si bashkëmoshatarët e tyre, të ndiejnë dorën e kujdesit nga shteti, për të cilin prindërit e tyre kontribuojnë me punë e taksë. Po ashtu në gjendje të mjerueshme janë edhe ambientet e dy shkollave, asaj 9-vjeçare "Besëlidhja e Malësisë" në qytet, dhe të Shkollës së Mesme të Bashkuar "Oso Dauti" në fshatin Llugaj, për të cilat projektet janë prej vitesh të depozituara pranë Ministrisë së Arsimit, por titullarëve të kësaj ministrie as që u shkon mendja për t'i financuar këto projekte.

Sikurse e theksova edhe më sipër, nëse ekziston dëshira e mirë, mundësia për financimin e këtyre 4 projekteve mund të bëhet realitet, pasi vlera totale për financim nuk kalon as 1,5% të vlerës së planifikuar për shpenzimet e luksit të qeveritarëve. Fëmijët janë e ardhmja e këtij vendi, aq më tepër kur bëhet fjalë për një investim modest për banorët e një prej rrethëve me nivelin më të lartë të varfërisë dhe emigracionit në vend. Jam i bindur se me pak predispozicion dhe dëshirë të mirë nga ana juaj, kjo gjë mund të zgjidhet shumë lehtë nëse nuk i qëndroni linjës suaj të qeverisjes së manifestuar në këta 9 vjet, Sekretare e Sekretariatit për Procedurat, Votimin dhe Etikën Klotilda Bushka Drejtori i Shërbimit të Redaktorëve Krenar Hajdëri asaj të harresës dhe hakmarrjes politike për këta banorë,

duke i trajtuar si qytetarë të dorës së tretë, edhe pse këta paguajnë taksat e shtetit dhe kontribuojnë në zhvillimin e vendit si të gjithë bashkëqytetarët e tyre. Faleminderit!